



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

**V E N D I M**

Nr.24, datë 30.04.2007

**MBI**

**RIORGANIZIMIN E DISA NDËRMARRJEVE TË BASHKISË SË TIRANËS**

Në mbështetje të ligjit Nr.8652, datë 31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", neni 32, gërma "d", ligjit Nr.7582, datë 13.07.1992 "Për ndërmarrjet shtetërore", neni 23, pika 1, 2, neni 30, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.378, datë 12.08.1999 "Për kalimin e së drejtës së përfaqësuesit të pronarit për disa objekte pronë publike, organeve të qeverisjes vendore", Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.153, datë 3.04.1993 "Për kalimin e objekteve të mjeteve kryesore të ndërmarrjeve dhe institucioneve shtetërore", Udhëzimit Nr.6, datë 3.09.1992 "Për zbatimin e ligjit Nr.7582, datë 13.07.1992 "Për ndërmarrjet shtetërore", kapitulli III, neni 30, ligjit Nr.9228, datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" si dhe shqyrtimit të relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Tiranë, Këshilli Bashkiak,

**V E N D O S I:**

1. Të miratojë bashkimin e katër Ndërmarrjeve: Ndërmarrja Riparim Materiale Poligrafike, Ndërmarrja e Galanterisë, Ndërmarrja e Shërbimeve Mekanike dhe Ndërmarrja Metalike "Tirana" në një ndërmarrje të vetme, me qëllim administrimin më të mirë të tyre.

1.1 Emri i ndërmarrjes do të jetë **Ndërmarrja Metalike "Tirana"**

1.2 Bilanci përmbledhës i ndërmarrjes së krijuar me vlerë totale 66.661.616.7 lekë do të jetë rezultat i bashkimit të bilanceve të datës 31.03.2007 të ndërmarrjeve si më poshtë vijon:

- Ndërmarrja Metalike "Tirana"	38.129.827	lekë
- Ndërmarrja e Galanterisë	10.295.044.7	lekë
- Ndërmarrja e Shërbimeve Mekanike	9.968.857	lekë
- Ndërmarrja Riparim Materiale Poligrafike	8.217.888	lekë

Shih **tabelën Nr.1** bashkëlidhur, pjesë përbërëse e këtij Vendimi.

1.3 Selia e Ndërmarrjes do të jetë ajo e Ndërmarrjes Metalike "Tirana", rruga e Durrësit, Tiranë.

1.4 Fusha e veprimtarisë së ndërmarrjes së bashkuar Metalike "Tirana" do të mbetet e pandryshuar, ajo e prodhimeve metalike (kangjella, kosha etj).

2. Bashkimin e dy ndërmarrjeve në varësi të Bashkisë: Uzinës së Pjesëve të Ndërrimit të Automjeteve dhe Rërë – Shtufit në një ndërmarrje të vetme, me qëllim administrimin më të mirë të këtyre ndërmarrjeve.
  - 2.1 Emri i ndërmarrjes do të jetë **Uzina e Pjesëve të Ndërrimit të Automjeteve (U.N.P.A)**.
  - 2.2 Bilanci përmbledhës i ndërmarrjes së krijuar me vlerë totale 48.153.666.5 lekë, do të jetë rezultat i bashkimit të bilanceve të datës 31.03.2007 të ndërmarrjeve si më poshtë vijon:

- Uzina e Pjesëve të Ndërrimit të Automjeteve	45.645.469 lekë
- Ndërmarrja Rërë - Shtufi	2.508.197.5 lekë
  - 2.3 Selia e ndërmarrjes do të jetë ajo e U.N.P.A Shkozë.
  - 2.4 Fusha e veprimtarisë së ndërmarrjes së bashkuar U.N.P.A do të mbetet e pandryshuar, ajo e prodhimit të pjesëve të ndërrimit të automjeteve.
3. Në zbatim të pikës 1 dhe 2 të këtij Vendimi të kryhen veprimet kontabël dhe të merren masat për zbatimin tij, sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.
4. Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohen: Drejtoria Metalike “Tirana”, Ndërmarrja Riparim Materiale Poligrafike, Ndërmarrja e Galanterisë, Ndërmarrja e Shërbimeve Mekanike, Ndërmarrja e Rërë - Shtufit dhe Uzina e Pjesëve të Ndërrimit të Automjeteve.
5. Ky Vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**K R Y E T A R I**

**SOKOL DERVISHAJ**